



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

No 21553 Prot

Tiranë, më 22.9.2017

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi
Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**
Për publikim: Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të Ligjit 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligjit 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe VKM-së 921 datë 29.12.2014, i ndryshuar, shpall konkurimin e hapur për pozicionin:

- **Inspektor Antikontrabande**, në Sektorin e Antikontrabandës Detare, në Drejtorinë e Antikontrabandës, Kategoria C2, Kategoria e pagës IV- a (tre vende)

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë:

1. Të kenë shtetësi shqiptare;
2. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të gëzojnë shëndet të mirë për të kryer detyrat e tyre;
4. Të mos kenë qenë të dënuar për krime dhe që nuk gjykohen për një çështje penale në ngarkim të tyre;
5. Të mos kenë qenë larguar më parë nga administrata shtetërore për thyerje të disiplinës ose shkelje të tjera serioze;
6. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat ekonomike, juridike, natyrore, politike etj.
7. Të kenë njohuri në përdorimin e kompjuterit.

Avantazhe:

1. Të ketë eksperiencë pune në Administratën Shtetërore.
2. Njohja e një gjuhe të huaj.
3. Njohuri në fushën doganore.

Përshkrim përgjithsues për pozicionin:

- Të parandalojë dhe zbulojë kontrabandën dhe çdo trafik tjetër të paligjshëm në territorin doganor ujor, vijën bregdetare dhe zonën doganore ujore.
- Të kryejë drejtpërsëdrejti kontroll për zbulimin e shkeljeve doganore veçanërisht për kundravajtjet dhe kontrabandën dhe të mos lejojë transportimin e mallrave, likuideve nga anija në mjete të ndryshme lundruese dhe në vende jashtë zonës doganore pa miratimin e autoritetit doganor.
- Të ndërtojë taktika imponuese ndaj subjekteve që kërkojnë t'i shmangen kontrollit dhe detyrimeve doganore, si dhe të kryejë kontrolle dokumentare dhe fizike mbi bazën e informacioneve dhe analizës së riskut në porte.
- Të kontrollojë dhe bllokojë shkarkimet në vende të pamiratuara nga Autoriteti Doganor dhe të bëjë kontroll në tragetet e pasagjerëve të linjës për mallrat e akcizës dhe lëndë të tjera që përbëjnë objekt kontrabande.

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë vijon:

1. Kërkesë për marrje pjesë në konkurim;
2. Curriculum Vitae;
3. Diplomë dhe Listë Notash të noterizuar;
4. Dëshmi Penaliteti;
5. Vërtetim nga Gjykata;
6. Vërtetim nga Prokuroria;
7. Vërtetim nga Tatim-Taksat;
8. Raport mjeko-ligjor;
9. Kartë identiteti;
10. Fotokopje të librezës së punës;
11. Fotokopje të kurseve kualifikuese.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më sipër.

Procedura e përzgjedhjes bëhet nëpërmjet vlerësimit të dosjes personale dhe me intervistë. Kandidatët që marrin mbi 50 pikë në vlerësimin e dosjes konsiderohen të kualifikuar për të marrë pjesë në intervistë. Kandidatët e përzgjedhur duhet të marrin mbi 70 pikë në intervistë. Rezultatet e intervistës bazohen në vlerësimin e përvojës, në kualifikimin dhe aftësitë e kandidatit.

Data e intervistës do të caktohet në një njoftim të dytë.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 02.10.2017, ora 16:00 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Belinda Ikonon

